



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.12, datë 04.06.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: "MORINA OFFICE - 7 KATE
MBI TOKË ME 1 KAT NËNTOKË", ME VENDNDODHJE NË
RRUGËN E ULLISHTES, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullore së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozim të subjektit zhvillues "Rinia 04" sh.p.k Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Morina office - 7 kate mbi tokë me 1 kat nëntokë", me vendndodhje në Rrugën e Ullishtes, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Rinia 04" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullore së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 24/6 / 2024